

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Kazanët do kene karakteristikat si më poshtë vijojnë:

Te dhena teknike te kazanit 1100 litra:

Trupi i kazanit

Cilesia e kazaneve metalike duhet te jete e tille qe te lejoje jetegjatesi nen nje perdorim intensiv dhe ti beje balle kushteve ekstreme klimaterike, goditjeve, gerryerjes dhe zjarrit. Kazanet duhet te jene lehtesisht te riparueshem dhe te mund te saldohen (trupi, kapaku, rrota). Trupi dhe kapaku metalik i galvanizuar (hot-dip) ne nje mase zinku 99.9% te paster (zinkuar). Trashesia e pjeses metalike te trupit te kazanit :1.5mm-4mm. Sistem kullimi fundor per derdhjen e lengjeve te grumbulluar nga mbetjet apo gjate larjes se kazanit. Sistemi ngrites i pershtatshem per nje mjet teknologjik. Ky sistem do te jete i njejte me sistemin aktual me te cilin jane te pajisur kazanet qe perdor Bashkia Shijak.

Sinjalistika

Kazanet duhet te kene ne balle te tyre funksionin qe do te kryejne. Lyerja e trupit te kazanit dhe kapakut do te behet me ngjyren qe eshte vendosur nga Autoriteti kontraktor si me poshte:

-



Kazani duhet te kete te stampuar “Qytetarë! Së bashku të mbajmë pastër mjedisin!”, shirita fosforeshente ne kater kendet, per te qene te dukshem naten dhe ditën. Kazani duhet te jete strukturuar ne menyre te tille qe te garantoje nje mbajtje peshe deri me 500 kg pa pesuar asnje deformim permanent. Kazani duhet të jetë në gjendje të durojë gjatë kohës, për të gjithë përbërsit, temperatura nga -20°C deri +50°C;

Rrotat

Rrotat duhet te jene me rezistence te larte me nje kapacitet ngarkese qe kalon 250 kg per rrote. Pjeset metalike te galvanizuara (zinkuara) ne qender dhe unaze gome rezistente ne pjesen e kontaktit me token. Dy nga kater rrotat fiksohen me frena. Diametri i rrotes 200 mm, me rrotullim 360 grade Te kater rrotat te jene te kthyeshme (me koke rrotulluese), me gome plastike solide, me kuzhineta.

Kapaku

Metalik. Me përforcues të tërthortë për ekstra rezistencë. Profil i harkuar me suste me gome me kanale për rrjedhje të ujrave të shiut. Kapaku duhet jetë i pajisur edhe me një dorezë, në pjesën e përparme , për hapjen e kapakut në mënyrë manuale. Kapaku te kete mekanizem per hapje me kembe.

Përputhja

Sipas normativës UNI EN 840 (UNI 10571).

Peridha e garancise :minimumi 1 vit.

Te dhenat teknike te kazanit

gjatesia	1360 mm
lartesia	1420 mm
gjeresia	1050 mm
kapaciteti	1100 litra
pesha	148kg
materiali i trupit te kontenierit	Llamarine e paster d=1.5mm-4mm
Lloji i celikut	C,0361 dhe C,0146 ose me kualitativ
Materiali i kapakut te kontenierit	Llamarine e pastruar d=1.5 mm-4mm
Forma e kapakut	I harkuar me sust,me gome mbi vijen dhe mekanizmi per pershtatjen
Numri i dorezave per hapjen e kapakut	Dy anash,majtas dhe djathtas
Numri i rrotave	4 cope
Dimensionet e rrotave	Ψ(fi)200 mm me gome mishi
Aksi i rrotave	Me kuzhineta
Levizshmeria e rrotave	360 grade
Fuqia e mbajtjes se peshes se rrotave	500 kg
Sistemi i rrotave	Me mekanizem frenimi te dy rrotave te para
Ngjyrosja	Me boje per metale dhe antindryshk e tere siperfaqja dhe pjeset e kontenierit